



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Regulatory Authority of Electronic and Postal Communications
Regulatorni Autoritet za Elektronske i Poštanske Komunikacije

Nr. Prot. 072/B/12

VENDIM Nr. 279

për

Miratimin e dokumentit për këshillim publik për

`Planin e Përdorimit të Brezeve Frekuencore në Republikën e Kosovës`

Në mbështetje të nenit 82, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Komunikimet elektronike Nr. 04/L-109, të datës; 04 Tetor 2012 (tutje referuar si – Ligji); Udhëzuesit për procedurat e këshillimit me publikun të miratuar me Vendimin Nr. 149 (Ref. Nr. Prot. 064/B/11) të Bordit Drejtues (tutje referuar si – Udhëzuesi); nenit 20 të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi Drejtues i ARKEP në përbërje nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha, Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha, Anëtar
- 3) z. Lulzim Kurtaj, Anëtar
- 4) z. Nijazi Ademaj, Anëtar

në mbledhjen e XLI me radhë të mbajtur me datë; 27 Nëntor 2012, mori në shqyrtim dokumentin e paraqitur nga Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave (DMF) të Draft Planit të Përdorimit dhe Shfrytëzimit të Brezeve Frekuencore në Republikën e Kosovës.

Pas shqyrtimit të dokumenteve të prezantuara dhe rrethanave të reja të krijuara nga hyrja në fuqi e Ligjit për Komunikime Elektronike (baza e re ligjore e aplikueshme);

- i. Draft Planit të Përdorimit të Brezeve Frekuencore në Republikën e Kosovës; dhe
- ii. Përmbylljes së fazës së konsultimeve interne mes ekspertëve të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të autorizuar sipas udhëzimit të Bordit Drejtues (Ref. Konkluzioni i pikës 6 të Procesverbalit Nr. Prot. 071/B/12) dhe të qarkulluar përmes e-mail të datës; 07/11/2012.

A T Ë H E R Ë;

Me qëllim të;

- Zbatimit të Ligjit për Komunikime Elektronike, Nr. 04/L/109, nenit 10 paragrafi 11) ku parashihet kompetenca e Autoritetit për miratimin e Planit për Përdorimin e Radio Frekuencave (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit;
- Vendosjes së kushteve bazë për ndarjen dhe dhënien e frekuencave, me qëllim të përdorimit efektiv të spektrit të radio frekuencave dhe shmangien e interferencave;
- Sigurimit dhe nxitjes së konkurrencës efektive në ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera përmes;
- promovimit dhe sigurimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;
- nxitjes së investimeve efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe sjelljes së zhvillimeve të reja teknologjike me qëllim të sigurimit dhe ofrimit të një cilësie sa më të lartë të shërbimeve dhe produkteve të tyre;
- nxitjes së përdorimit efikas të frekuencave si një nga burimet e fundme, në mënyrë që procedurat dhe planet e përdorimit dhe shfrytëzimit zbatohen në atë mënyrë që i sigurojnë dhe japin trajtim të barabartë të gjithë ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut,
- Përafrimit dhe harmonizimit të Rregullores me legjislacionin aktual të aplikueshëm në/me vendet e Bashkimit Evropian;

Bordi Drejtues i ARKEP mori këtë vendim;

VENDIM

- I. Miratimin e fillimit të procesit të këshillimit publik për dokumentin e **`Planit të Përdorimit të Brezeve Frekuencore në Republikën e Kosovës`** sipas dokumentit administrativ, Nr. Prot. 090/A/12, të bashkëngjitur si pjesë integrale të këtij vendimi.
- II. Procesi i këshillimit publik fillon me datë; **5 Dhjetor 2012 dhe përfundon me datë; 5 Janar 2013.**
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

BAZA LIGJORE

- 1) Nenet; neni 10 paragrafët 4) dhe 11), neni 79 paragrafi 2), të Ligjit Për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 i miratuar me datë; 12/10/2012;

- 2) Vendimit Nr. 04-V-93 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e `Planit Kombëtar të Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Frekuencor¹` të datës; 23/06/2011;
- 3) Nenit 20 të Rregullores së Brendshme të ARKEP, (Ref. Nr. Prot. 161/06)

Këshilla Juridike;

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vërtetim;

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ARKEP ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ARKEP-it.

Prishtinë, 03/12/2012

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet;

- Ndërmarrësve dhe Operatorëve të autorizuar të ofrojnë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, MZHE
- Departamentit të Telekomunikacionit, ARKEP
- Arkivit të ARKEP-it

¹ Sipas nenit 4 – Përkufizimet të Ligjit Nr. -4/L/109 për Komunikime Elektronike i njohur si `Plani Kombëtar i Radio-Frekuencave`